

# Formula e dritës në një vëllim

nga Anton Çefa

Kohët e fundit, poezia shqipe e bashkësisë sonë dhe e botës shqiptare, në përgjithësi, u pasuria me vëllimin poetik të poetit Gjokë Marinaj, të titulluar "Infiniti".

Lexon këtë përmbledhje lirikash dhe përjeton estetikisht dhe intelektualisht një infinit të trefishtë: infinitin qiellor të një hapësire të kaltër përfytyrimi poetik, një infinit dramatik shqetësimësh tokësore dhe një infinit human mesazhesh fisnike.

"Mbetem tërë jetën duke rendur pas ikseve njerëzore"

thot poeti. Dhe më përtej:

"Tërë jetën të mundur nga formula e dritës."

("Bilanc", f. 84)

I tillë është "Infiniti": një rendje poetike pas ikseve të njerëzimit, për t'u përkapur me mundim dhe jo edhe pa u mundur tek formula e dritës. Janë pikërisht ikset njerëzore, që i kanë diktuat poezisë së Marinajt motive që lidhen me shqetësimet e njerëzimit, në përgjithësi, dhe të botës shqiptare, në veçanti. Janë shqetësimet e përgjithmonshme: dashuria, fati i njeriut, qëllimësia e jetës, rruga dramatike që përshkon ai, përpjekjet heroike të tij në emër të vënies në jetë të idealeve, roli i artit, sidomos atij poetik në dobi të shoqërisë, etj.

I tillë është "Infiniti": një ravigim në hullinë e krijimit poetik, ku përfaqsen koncepte estetike, etike, sociale, politike, etj.: e bukura dhe e shëmtuara, e mira dhe e keqja, e drejta dhe e padrejta, e madhërishtja dhe e çoroditura, duke formësuar në sajësën e begatshme të imagjinatës-motive të diktuara e të ngjizura nga një dell poetiko-dramatik i fuqishëm, që vijin tek lexuesi si një kumt drite, që përthyer harmonishëm në ndriçim të skajeve më mospërfillëse të vetëdijes së tij. Natyrisht, të atij lexuesi, që përpiqet me durim të kuptojë a më mirë të përfytyrojë poezinë; çdo fjalë, çdo varg, çdo figurë të saj.

Vëllimi hapet-jo pa qëllim-me erotikën. Dashuria si hapësira më e kaltër, më e dritshme, më universale dhe më njerëzore përbën çelësin e artit të dilemës njerëzore, të qëllimësive në jetë. Ajo është vetë dilema jetësore e gjithmbarshme, që kërkon të dritësohet me formulën e dritës. Këtu, bile, nuk është formula, këtu është vetë drita.

Dashuria, e motivuar kryesisht si dashuri për femrën, është elementi kryesor, demiuergu i jetës, i vetë gjithësisë. Ajo kuptimëson jo vetëm planetin tonë, por gjithë universin:

"Tërë zogjtë e botës u çuan prej vargjeve të Nerudës dhe u shfaqen t'u japin kuptim qiejve."

Thuhet në poezinë "Cili nga ne jam unë" (f. 37), duke aluduar tek poeti kilian, Pablo Neruda, (fitues

i çmimit Nobel, në vitin 1971, me vëllimin "Njëzet poezi dashurie"), i cili përmendet si Petrarka i kohëve moderne.

Nëse dashuria është dera e parë e dritës, çelësi për ta hapur këtë derë është bukuria. Fuqia e bukurisë femërore mposht bukurinë e natyrës, por mposhtet nga bukuria e dashurisë, sepse dashuria për njeriun është arsyeja e qenies (parimi filozofik më human i finalitetit):

"Kemi lindur për të dashuruar"

Bukuria e vajzave është e pranishme kudo ("Shoqet e zyrës sime", f. 92), sepse "pa vajzat vetë bukuria ndjehet jetime" ("Vajzat e Kalifornisë", f. 19). Pushtetit të kësaj bukurie i nënshtrohet natyra dhe çdo gjë: "Ajo u nis për Evropë/ Kushedi sa më e bukur do të ngajë Evropa prej saj." (f. 47). Forca e bukurisë femërore, pushteti i saj detyrojnë çdo burrë "të kërkojë nënshtetësi tek atdheu i tyre i bukurisë" (f. 22).

Në perlën poetike "Gusht, diku në ishujt e Meksikës" (f. 23), e endur si në një tis balade, bukuria e detit tërhiqet nga bukuria e vajzës:

"E bukura e detit e la mënjandë detin për mua./ Deti qan, mbledhet, hapet e përplaslet plot zhurmë./ Dallgët si marinare që s'kanë më asgjë për të humbur/ japin jetë në grimcat e rërës."

Heroi lirik i kësaj poezie e harron veten i joshur nga bukuria e vajzës dhe ajo vetë e harron detin:

"Gjysma prej peshku e gjysma prej ëndrrë ajo, gjysma prej gjetheje e gjysma prej fruti unë, gjysma prej të çmenduri e gjysma prej të vdekuri deti."

Dashuria e njëjtëson jetën e çiftit të dashuruar: një ndjenjë, një qëllim, një përpjekje, një vullnet. ("Sepse një ditë të pashë me detin", f. 30).

Dashuria ka në vetvete forcën e fisnikërimin të njeriut:

"Të dua/ jo vetëm për bukurinë tënde, Por edhe pse sa i hijshëm ndjehem unë Kur jam me ty."

Të dua/ sepse çiltërsia e të qeshurës tënde Më rrit vlerat e fytyrës." ("Të dua", f. 35).

Në vargjet e ciklit erotik "Cili nga ne jam unë" janë të shkruara në një bukuria femërore, çifti i dashuruar, vetë dashuria dhe koncepti filozofik i saj, në një mënyrë të harmonishme si detajet e një tabloje klasike, siç është bërë zakon të thuhet. Marrëdhëniet e njeriut me dashurinë janë dhënë jo vetëm në rrafshin erotik si përjetime ndjenjësore, në një truall plot vlagë përfytyrimi, por me po aq forcë edhe në rrafsh universal-ndonjëherë edhe duke kapërcyer kafirin e poezisë-me përcaktime ku vendin e fjalës-figurë e ka zënë fjala-termë:

"Po njeriu, ç'është njeriu tek dashuria ?

Unë do të thoja

Universalizmi tek e njëanshmja.

Kurse dashuria tek njeriu

është arsyeja e ekzistencës."

("Kemi lindur për të dashuruar", f. 27).

Drama e njerëzimit, e projektuar kryesisht në rrafshin moral, është një nga burimet më me peshë të shqetësimit poetik të Marinajt, duke bërë që në vargjet e "Infinitit" të rrjedh jo vetëm shqetësimi i kohës sonë, por edhe i të gjitha kohërave. Dilema e qenies tani është lëruar në truallin moral. Kjo, sepse jetojmë në një hapësirë, ku "njeriu në vend të fjalës për-typ njerinë" (f. 112), në një kohë kur "trendafilat lëshojnë shtat me rrënjë në gjak" (f. 82), "kur vetë njeriu e shtyn jashtë njerëzve njerinë" (f. 112), kur "dikush akoma ka sy për ngjyrat e lëkurës, por është i verbër pranë vlerave njerëzore" (f. 116), etj. Njerëzimi, edhe pse duke u mundur prej këtyre "ikseve", duhet të përpiqet të ngjitet tek formula e dritës, që e vetëdijëson dhe e dritëson atë.

Dy polet ndjenjësore në fushën e moralit: dashuria dhe urrejtja, që përçojnë në kahe të kundërta drejt formulës së dritës ose të errësirës motivojnë jo pak lirika të "Infinitit". Në poezinë "Fëmijëria nuk është më aty" (f. 62), porsa çeket motivi "

"hijet e trupave tanë u tjetërsuan anekseve të dashurisë, urrejtjes"

Katarsi moral jetësohet si një rrugë për t'u dritësuar.

"Dhe të imagjinojmë veten krahëhapur si një kryq pa lidhje me Krishtin

ku në njerin krah mbajmë çiltërsinë e fëmijërisë dhe thesin e mëkateve të rritjes përpiqemi të ekuilibrojmë në krahun tjetër.

Le të bëhemi vetë peshorja e drejtësisë së vetvetës." (f. 61-62)

Ndërsa në poezinë "Dy qiej midis meje dhe vetes" (f. 75), në parkun botanik të Garlandës, poeti rrëfëhet:

"Dashuria dhe urrejtja akoma më qëndrojnë si dy qiej diku tretur mes meje dhe vetes."

Dashuria dhe urrejtja kanë ecur gjithnjë pranë e pranë dhe njerëzimi, fatqësisht, nuk ka mundur ta mposhtë urrejtjen. E gjithë historia e njerëzimit na e dëshmon këtë.

Poezia shqipe e njeh një shqetësim të tillë, por kjo nuk i është bërë pengesë Marinajt për një trajtim krejt origjinal. Heroi lirik i poezisë "Më falni diçka" të Martin Camaj, për hir të dashurisë njerëzore shpall:

"Mordjen do ta puthi ndër buzët e ngrime dhe në zgavrërat e synit të saj do të derdhi lot". Dhe mandej shpërthen:

"Avitu njeri!

Nga palci i urrejtjes dëshiroj me dalë

Si bima prej fare në pranverë."

Është pikërisht thirrja "Avitu njeri!" ekuacioni më rëndësor për të arritur tek formula e dritës. Sepse është dashuria që dritëson.

Tek poezia që përmendem më lart, Marinaj "nuk e puth mordjen ndër buzët e ngrime", por shkon në park të dritësohet. Një mesazh që bën fjalë për katars personal: "Të gjelbërohem vij/ tek kjo atmosferë kafe e parkut botanik/ në dimrin e pafund." Vetëm një poezi me permasa të denja e dinjitoze mund të përkapet tek motivet universale, aq e aq herë të trajtuara, dhe t'i realizojë ato në mënyrë origjinale e me aftësi të lartë përfytyruese.

Në një rrafsh tjetër füllimi, në këtë poezi është shprehur dualiteti i njeriut në prehërin e së mirës dhe të së keqes, të dritës dhe të errësirës dhe ideali i tij drejt dritës, motiv që trajtohet edhe në poezinë "Infiniti", e cila i ka dhënë tinalin vëllimit, dualitet që dyshimëson realizimin e përsosmërisë njerëzore. Kështu, peshuar në "kandarin" e drejtësisë shoqërore, njerëzit mbetën në pozicion të pacaktuar:

"minus pafundësisht të ashtushëm e plus pafundësisht të këtuashëm" (f. 83).

Komentuar më përtej, në një hulli tjetër, tek kjo poezi qëndron dilema e përjetshme dhe universale mes arsyes dhe ndjenjës. Cila duhet të jetë shtypa kryesore e veprimtarisë, sjelljes, qëndrimeve të njeriut: arsyeja apo ndjenja ?

Oqeani jetësor është i mbushur me aisbergë ("Aisbergët", f. 78), për-ftohtësinë e të cilave, njeriu "është tepër i tejdukshëm të jetë i pranueshëm" dhe "më e keqja është/ se nuk duhet të ruhemi nga aisbergët/ vetëm në Oqeanin e Ngrirë të Veriut", sepse "ata ngrijnë oqeanin e ëndrrave kudo/ diku gjatë të sotmes dhe të nesermes..."

Fisnikërimi i njerëzimit mund të arrihet vetëm nëpërmjet flitimit në emër të idealeve më të larta, gjë që mund ta jetësojë vetëm heronj e heroina si Antigona:

"E kujt i duhet jeta kur ajo vetë brenda njeriut është e pajetë ?" ("Antigona", f. 77)

(Për hir të shkoqitjes së poezisë, më duhet të them dy fjalë për mitin e Antigonës. Antigona është e bija e Edipit, mbreti të Tebës, dhe e Jokastës. Kur vëllezërit e saj, Etokli e Poliniku, vrasin njeri-tjetrin në luftë për çeshtje të fronit mbretëror, Kreoni, daja i Antigonës, mbreti i ri i Tebës, nuk lejon të varrosët Poliniku,

## Call & Talk

Netherlands	9.5¢
Denmark	6.2¢
Canada	7.5¢
USA	6.5¢
Bosnia	20.9¢
Italy	9.5¢
Germany	8¢
Albania	20.9¢
Croatia	19.5¢
Kosovo	19.9¢
Greece	25¢
Macedonia	24.9¢
France	8.9¢
Belgium	9¢
Spain	9.5¢
Bulgaria	22.9¢
Slovenia	24.2¢
UK	7.5¢
Hungary	18.9¢

Great rates to all countries  
Rates are valid 24hours a day  
6 seconds billing  
Customer Services - 24x7

Long Distance Post  
1-800-449-0445

www.LDPOST.COM

## Free ESL! 4 - weeks!

If you are a Green Card holder, or you obtain Political Asylum, Refugee or Parole status ASA Institute offers you

Free of Charge course of English as a Second Language with the further choice of the exciting program that gives you skills and knowledge that are in demand in today's market.

For information about Free ESL Course call:

### 1-877-709-2162

Ask for Elvira ext. 188



# poetik që pasuroi poezinë shqipe

duke e paditur atë si trahhtar. Antigona i kundërvihet, duke varrosur të vëllanë, dhe Kreoni e dënon me vdekje. Ky mit ka shërbyer si subjekt i tragjedisë së Sofokliut dhe tragjedianit francez të kohëve tona, Jean Anouilh (1910-1987).

Figura thellësisht tragjike e Antigonës është quajtur nga studiuesja e shquar amerikane, Edith Hamilton, "figura më tragjike mbas asaj të Krishtit".

Sado në njëfarë hullie vetanake, heroizmi i Antigonës është prometean për nga fuqia dhe me kahje të kundërt për nga përmbajtja, sepse në mitin e Antigonës është ligji hyjnor dhe njerëzor së bashku, që i kundërvihet pushtetit mbretëror, diktatorial.

Më përtej, nuk është vetëm ndeshja mes ligjit hyjnor e zakonit nga një anë dhe urdhrit njerëzor, nga ana tjetër, që përbën tragjedinë, siç është komentuar përgjithësisht, por është edhe thjeshtë një kërkesë, një nevojë humane që buron nga një dashuri e pakufishme dhe, mbi të gjitha, është vetë Antigona aq e stërmunduar në jetën e saj, dhe aq e madhërishtme në vdekjen e saj, që me vendosmëri flijon veten për hir të idealit e të botëkuptimit të saj. Ajo i dorëzohet vdekjes për hir të dashurisë, në moshën më të bukur të jetës: ajo "fshin të gjithë kufijtë në hartën e dashurisë", thotë poeti.

Në poezinë e Marinajt, Antigona është dhënë në momentin e fundit të jetës së saj, kur ajo plotësisht e ndërgjegjshme, mospërfillëse, përbuzëse, e guximshme dhe e vendosur për veprimin e saj hedh, simbas zakonit, disa grushta dhe mbi trupin e pajetë të vëllait, Polinikut:

"Ajo nguli gishtërinjtë në javën e fundit të tokës si shtatë kalemata e mbetuna të Sofokliut."

Siç thuhet, Sofokliu ka shkruar 123 tragjedi, prej të cilave kanë ardhë në kohën tonë vetëm shtatë, duke përfshirë Antigonën.

Në strofën e dytë tregohet qëllimi i veprimit të saj, i flijimit, dhe vetë veprimi: "mbushi bulshijë me vdekje" dhe me këtë veprim "pështyu mbretin Kreon në fytyrë". Në strofën e fundit është dhënë mesazhi: vetëm një ideal i lartë dhe flijimi në emër të tij e kuptimëson jetën.

Poezia për Antigonën është një ese e vërtetë poetike, e sajuar vetëm me 12 vargje, me vlera të pakufishme ideore e artistike, një koment sa më i plotë i së cilës kërkon faqe të tëra.

Dy harqe motivesh lidhen me ikset e jetës e të botës shqiptare, ku drita dëpërton rryshëm e më rryshëm dhe formula e saj ndeshet me aq e aq pengesa për t'u zbatuar. Shqetësimi shqiptar, që nga familja e fshati tek atdheu e kombi, është i endur në një pël-hurë të mëndafshhtë ndjenjash dhe vizionesh të dritshme, që gjallërojnë më së tepërmi në një truall ëndrrë. Veç në një qiell ëndrrë, poeti mund ta përjetojë dhe ta projektojë realitetin tragjik të Shqipërisë dhe të të gjithë botës sonë.

"Sonte do të shkas tinëzish nga gjumi me maskën e ëmbël të një ëndërrë në fytyrë. Të lutem, kështu bën edhe ti, Shqipëria ime!

Udhëkryqeve të qiellit le të takohemi sonte. Nuk do ta kesh të vështirë njohjen time. Oh, ngjasim aq shumë, e mira ime!

Dua të shihemi sy më sy, e dashur! Edhe sikur të vërbohem nga madhështia jote, Ashtu qorr, veten dhe të tjerët do t'i shoh më mirë." ("Shqipëri", f. 98)

Janë vargje aq të bukura në thjeshtësinë e tyre më të skajshme, sa që ke frikë t'i komentosh. Këtu formula e dritës është e zgjidhur me dritë. Një rreth vicioz, vërtet, por i mbushur, i ngopur tejet me dashuri dhe art.

Shqetësimi dramatik për Kosovën kalon tek i gjithë njerëzimi, ku e keqja, padrejtësia është një dukuri e zakonshme:

"Engujt me peshoren e drejtësisë hyjnore në duar druhen se toka është tepër poshtë, njerëzimi është tepër ireal, i çmendur, që barazia humane të njomë buzët e çdo njeriu" ("Mëngjes i mjergullit kosovar", f. 91)

Duket se Olimpi nuk është i fuqishëm të vendosë drejtësi mbi botën dhe mbetet mospërfillës përballë padrejtësisë tokësore. Ai është tepër lart dhe toka tepër poshtë. Këtë shqetësim dramatik, poezia jonë e ka njohur, bile me një intensitet tejet tragjik: Fish-ta, me zhgunin e vrazhdë të kësaj drame në trup e në shpirt, duke aloduar për gjendjen e Shqipërisë, tek "Juda Makabe", qortonte Zotin:

"O Perëndi, a ndjeve ?

Trahhtarët na lanë pa atdhe e Ti rri e gjen me rufe lisat nëpër male kot..."

Në një përfytyrim përgjithësues është dhënë historia tragjike dhe njëheri e lavdishme e Kosovës:

"Fytyra jote i hapi krahët e përgjakur si fletë drite, që andej pikoi pigmenti që i ruajti ngjyrën flamurit dhe e mbajti të fiksuar në zjarmi zhivën termometrit të durimit." ("Kosovës", f. 93)

Është Kosova që i ka ruajtur ngjyrën flamurit dhe është ajo që edhe pse ka vuajtur zjarminë e robërimit, i ka dhënë aq e aq atdheut, sa për antonomazi, studiuesi Hamit Kokalari e ka qua-

jtur "djepi i shqiptarizmit" Lavdia e saj e fituar me trimëri deri në flijim do të jetë e përrjetshme:

"Ti Kosovë e dashur, edhepe e keqhedhur në çengelat e vdekjes trimëria jote do të qëndrojë e shpërndarë në ajrin që e thithë e ardhmja.

Një hark më vete i motiveve të "Infinitit" lidhet me artin, në përgjithësi, dhe me poezinë, në mënyrë të veçantë, dhe ngërthen në hullinë e vet vlerën dhe funksionin e lartë shoqëror të artit, qenësinë e poezisë e të poetit, idealin poetik, marrëdhëniet e poetit me shoqërinë, etj.

Në poezinë e Marinajt, arti ka një peshë të madhe shoqërore, vlera e tij është universale dhe e përrjetshme. Ai i jep vlerën kohës, e pasuron dhe e fisnikëron atë shpirtërisht. Në poezinë "Jeta do të soset më vonë" (f. 50), kushtuar piktorit post-impresionist holandez Vinsent Van Gogut (1853-1890), e cila i referohet dy pikturave të këtij piktori me famë botërore: "Këpuçët" dhe "Luledielli", koha ka shtangur si një fëmijë para bukurisë dhe madhësisë së artit të madh, që jo vetëm e pasuron jetën, po e bën edhe më të gjatë. Vetëm në 6 vargje janë njëmendësuar të tëra këto ide të mëdha.

Në poezinë e këtij cikli është realizuar ideja e rolit shoqëror të poezisë dhe vetë poetit, të cilit "trup i varet çengelave të jetës" (f. 54), ose që "pa e kuptuar shtrydh veten jashtë jetës/ dhe që të rrojë mbushet me tokën, me njerinë" (f. 49).

Fisnikërinë e lartë të këtij ideali poetik, Marinajt ia ka ushqyer familja, edukata e shëndoshë që ka marrë atje që në fëmijëri dhe që e "stërpik në fytyrë si qumësht poetik" edhe sot e kësaj dite ("Shtëpia në Brut", f. 157), fshati i tij i lindjes, Bruti i Malësisë së Madhe dhe e gjithë Shqipëria. Shtëpia mbetet kështjella ku poeti mbron poezinë "nga lufta e rrëzimit me ngritjen tek jeta" (po aty). Ajo e fton "të mbetet përgjithnjë njeri para njeriut" (po aty).

Në poezinë "Kundraversale" (f. 51) janë vënë përballë poeti, populli, pushteti. Pushtetarët që nuk duan t'ia dinë vuezitjeve të popullit, të dëshmuara prej poetëve, i kërcënojnë këta të fundit. Realitet i hidhur shqiptar!

"Infinit" të nxitë të shkruash dy fjalë edhe për mjeshtërinë artistike.

Kushit i parë, më i qenësishmi, i poezisë lirike është krijimi artistik i një përfytyrimi sa më të pasur kuptimisht. Sepse lirika mbështetet tërësisht në figurën e imagjinatës së sajuar prej përjetimeve të poetit dhe të sendërtimit të saj nga lexuesi, gjatë leximit rikrijues që është gjithnjë individual. Vargjet që lexojmë janë vetëm lulet, kurse rrënjët, kërcëllin dhe gembat e tyre duhet t'i kërkojmë në përfytyrimet tona. Poeti nobelist italian Salvatore Quasimodo (1901-

1968), duke bërë fjalë për poezinë lirike ka shkruar: "Kur poezia fillon të thotë pushon së qeni"; ndërsa poeti amerikan Archibald MacLeish (1892-1982), në esenë e tij poetike "Ars Poetica", e ka përforcuar këtë mendim, duke thënë: "Poezia nuk duhet të thotë, por të jetë". Në dukje paradoksale-kështu është shprehur qenësia e poezisë lirike. Do të ishim plotësisht të gabuar, nëse në përcaktimet e mësipërme do të gjenim hermetizmin ose një poezi të pakuptimtë. Krejt e kundërta: dy poetët e shquar kërkojnë që poezia në sa më pak fjalë të krijojë një përfytyrim sa më të gjerë që të shprehë një përvojë sa më të pasur. Dhe me që në poezi nuk parashtrohen idetë, por jepet përjetimi vetjak i tyre nëpërmjet përfytyrimit ndjenjësor, lexuesit i duhet të të rigjallërojë, të rikrijojë në vetëdijen e tij përvojën përfytyruese të poetit, nëse dëshiron të përjetojë atë që Leonardo Da Vinci e ka quajtur "kënaqësinë më fisnike", gëzimin e të kuptuarit.

"Infinit" është i pasur me poezi aq të bukura, që trajtojnë në pak vargje ide rëndësore, dhe aq të pasura kuptimisht, sa që po t'i komentosh, duke zbrëthyer figuracionin artistik, të dalin ese të vërteta të ngarkuara me aq e aq ide. Si poezi të tilla po përmend: "Kundraversale", "Antigona", "Toka sillet habitur brenda brinjëve të poetit", "Jeta do të soset më vonë", "Minutat pjellin ditë-plakje", "Gusht, diku në ishujt e Meksikës", "Pa e kuptuar-Dusitës", "Shtëpia në Brut", "Fëmijëria nuk është më aty", "Luledielli", "Në Hollywood", "Dy qiej midis meje dhe vetes", "Baba dhe nëna", etj. Në disa poezi, motivi është shtjelluar mbi bazën e përfytyrimit të një teoreme fizike a matematike, a me përbërës ndërtimore që të kujtojnë teoremat - diçka krejt e veçantë - siç janë p. sh. "Në Kosovë", "Realitet virtual", poezia që i ka dhënë titullin vëllimit, "Infinit", etj.

Përzgjedhja e motiveve, veçoria e ndërtimit të një njësie poetike-që e çekem më lart-dhe vetë lënda e ndërtimit, figuracioni, i përshtaten dhe i shërbejnë kërkimit të formulës së dritës, duke i dhënë njësinë tërësore vëllimit. Figura në vetvete, sa e brishtë aq edhe e fuqishme, tejet e fuqishme dhe gjithmonë e dritshme, e ajrë, e freskët është jashtëzakonisht e pasur me një dëndësi të çuditshme përfytyrimi. Fryt i arrirë i një pune të mundimshme.

Si e tillë, ajo ka njëfarë origjinaliteti në vetvete që krijon diskutime, të cilat përkapen deri tek çështje teorike të ndërtimit figurativ. Në këtë këndvështrim, do të vija në dukje dy cilësi kryesore. Dalloja e parë qëndron në faktin që figura - zakonisht metafora - nuk mbështetet thjeshtë në një njësi ligjërimore, siç ndodh zakonisht me metaforën klasike, por shprehet me një sintagmë të përbërë nga dy a më shumë gjymtyrë.

(VLJON NE NUMRIN E ARDHSHEM)

## HELP WANTED

A busy Pizzeria in Long Island is looking for an experienced pizzaman and a counterperson. 15 minutes away from JFK.

For more information call Pete or Mike at (516) 374-5900

Illyria - e vetmja gazetë

shqiptaro-amerikane.

Forca e shqiptarëve në Amerikë

## International Driver's License

Translated from your original driver's license by IADC International Driver's License is issued according to Geneva Convention on Road Traffic ONLY ORIGINAL DRIVER'S LICENSE NEEDED FROM ANY COUNTRY

INTERNATIONAL DRIVING DOCUMENT

IF YOU WANT TO RECEIVE YOUR CARD BY MAIL YOU SHOULD PROVIDE THE FOLLOWING INFORMATION:

- 1) FIRST NAME, LAST NAME
- 2) FULL ADDRESS AND TEL #
- 3) DATE OF BIRTH
- 4) COUNTRY OF BIRTH
- 5) SEX (M) (F)
- 6) COLOR OF EYES
- 7) HEIGHT IN FEET AND INCHES
- 8) SIGNATURE
- 9) COPY OF DRIVER'S LICENSE FROM ANY COUNTRY (FOR DL)
- 10) 1 PHOTO (PASSPORT SIZE)
- 11) MONEY ORDER PAYABLE TO IADC CO FOR \$49.00 (DL) OR \$29.00 (ID) (\$4.00 - SHIPPING AND HANDLING)

WE HELP YOU TO GET: SOCIAL SECURITY SUBSTITUTION

NEW YORK

1) NOTARY CERTIFIED PHOTOCOPY OF YOUR PASSPORT (OR DL, OR BIRTH CERTIFICATE, OR MILITARY ID, OR INS DOCUMENTATION, ETC.)

2) ADDRESS IN YOUR NATIVE COUNTRY 3) FATHER'S LAST AND FIRST NAMES 4) MOTHER'S LAST AND FIRST NAMES 5) COUNTRY OF CITIZENSHIP 6) TYPE OF VISA (IF ANY) AND EXPIRATION DATE (OPTIONAL)

http://www.iadc-world.com

IF YOU'D LIKE TO GET SOCIAL SECURITY SUBSTITUTION, I.E. TAXPAYER IDENTIFICATION NUMBER, YOU HAVE TO ADD THE FOLLOWING: MONEY ORDER FOR \$70.00 and:

1739 SHEEPSHEADBAY RD, BROOKLYN, NY 11235

tel (718) 891-8159, 891-8169, tel/fax (718) 891-8149

Subway Trains D&Q to SHEEPSHEADBAY Office Hours: M-F 10-7:30 S-S 10-3

SPECIAL PRICE FOR AGENTS